



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 612 Prot.

Tiranë, më datë 06.12.2024

VENDIM
Nr. 512, datë 06.12.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.12.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor realizuar nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik dhe Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (FHF/UT) në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit “Pakti me Universitetin”, në zonat e Divjakës dhe Lushnjës, **me kërkesë të Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik në IKTK, me rekomandimet;**
 - Të kryhet gërmim arkeologjik shpëtimi për kodërvarret e identifikuar në “Kodrën e Pusit” në jug të fshatit Murrizë-Peqin në Bashkinë Lushnje;
 - Të kryhen sondazhe arkeologjike në “Kodrën e Kishës” në Kasharaj;
 - Të regjistrohen nga IKRTK elementet arkitektonike antike të identifikuar pranë kishave;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

